



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:005584

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05423803

P.nr. 84/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i përgjithshëm Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Refki Piraj, me bashkëpunëtorin profesionale Arbnijë Gashi, në lëndën penale kundër të akuzuarit H.B., nga fshati Lubizhdë, Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale, Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK- së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II Nr. 21-14/23, të datës 01.02.2023, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar, në prezencën e Prokurorit të Shtetit në Prizren Labinot Jetishi, të dëmtuarve A.B., të akuzuarit H.B., me datë 18.01.2024, mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me datë 29.02.2024 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari

H.B., nga i ati, e ëma, mbiemri i vajzërisë së nënës, i lindur me datënë fshatin Lubizhdë, Komuna e Prizrenit, ku dhe jeton, i martuar, i ati i një fëmije, ka të kryer shkollimin fillor, autolimar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Kosoves, me numër personal

Ë S H T Ë F A J T O R

Se me datë 06.01.2023, rreth orës 02:00^{min}, në rr. “.....”, në Komunën e Prizrenit, saktësisht në banesën e tij familjare, me dashje ushtron dhunën përkatësisht keqtrajtimin fizik, me qëllim që t’ i shkaktoj lëndime trupore personit tjetër dhe atë viktimës së ndjeshme - bashkëshortes së tij shtatzëne A.B., në atë mënyrë që pas mosmarrëveshjeve të vazhdueshme bashkëshortore që kanë mes vete, i pandehuri sapo kthehet në shtëpi fillon të fjaloset me viktimën dhe për një moment derisa ishin duke biseduar, me dashje e godet me grusht, e kap për flokësh dhe e mbyll në dhomë, me ç’ rast të njëjtës i shkakton lëndime të lehta trupor me pasoja të përkohshme për shëndetin, përkatësisht gërvishtje në qafë, reaksion stresogjen traumatik (shtatzënë muaji i tetë) të përshkruara sikurse në akt ekspertimin mjeko-ligjor të datës 16.01.2023.

Me këto veprime ka kryer veprën penale, Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK- së, nr. 06/L-074.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 4,7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 44 dhe 69, dhe nenit 185 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME BURGIM

Në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj burgim, në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në ndalim dhe paraburgim, nga data 06.01.2023, deri me datë 05.02.2023, me pëlqimin e të akuzuarit, dënimi i shqiptuar më burgim i zëvendësohet me dënim me gjobë, në shumën prej katërqind (400) euro, të cilën shumë do ta paguaj në llogarinë e kësaj gjykate nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse dënimi me të holla nuk mund të paguhet nga ana e të akuzuarit në afatin ligjore i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur 20 euro për 1 ditë burgim gjegjësisht 20 ditë burgim.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale në llogari të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor do të paguaj shumën prej 20 euro, në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumën prej 20 euro si dhe në emër të kompensimit për viktimat e krimit shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara A.B., nga fshati Lubizhdë Komuna e Prizrenit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka paraqitur aktakuzën nën numrin PP/II Nr. 21-14/23, të datës 01.02.2023, kundër të akuzuarit H.B., nga fshati Lubizhdë, Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale, Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK- së.

Pas pranimit të shkresave të lëndës, gjyqtari i vetëm gjykues me datën 18.01.2024 ka caktuar seancën gjyqësore, në të cilën seancë i akuzuari H.B., pas udhëzimeve të dhëna nga gjykata, duke kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, vullnetarisht kanë pranuar fajësinë për veprën penale e cila u vihet në barrë.

Prokurori i shtetit Labinot Jetishi ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Mbrojtësja e viktimave Ganimete Kitmir ka theksuar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

E dëmtuara A.B., ka theksuar se veprimet të cilat i ka kryer bashkëshorti im i kam falur, por ka kërkuar që bashkëshorti i saj të premton para gjykatës se këto veprime më nuk do ti përsëris.

I akuzuari H.B., ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale në tërësi si në aktakuzë, dhe i premton gjykatës që më nuk do të përsëris veprën penale, është thellësisht i penduar për veprimet që ka kryer.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka miratuar pranimin e fajësisë, ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 242 lidhur me 241 të KPPRK-së. Me rastin e pranimit të fajësisë, gjykata vërtetoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë,

se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, pranimi i fajësisë ka mbështetje në faktet dhe provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 244 të KPPRK-së, për pushimin e procedurës penale, përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Bazuar në pranimin e fajësisë nga të akuzuarit konform nenit 241 dhe 242 të KPPRK-së, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave.

Andaj, kjo gjykatë duke u bazuar në ato që u thanë më lartë, ka vërtetuar gjendjen faktike si në aktakuzë dhe me këtë rast, gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor duke i shqiptuar dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69, të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Si rrethanë lehtësuese ka gjetur pranimin e fajësisë në shqyrtim fillestar, rrethana të tjera lehtësuese mori parasysh, keqardhjen e shfaqur nga i akuzuari, si dhe rrethanat personale gjenden e dobët ekonomike, ndërsa si rrethana rënduese ndaj të njëjtit ka gjetur dashjen dhe shkallën e lartë të pjesëmarrjes së të tij në kryerjen e veprës penale, se veprën penale e ka kryer ndaj viktimës së ndjeshme bashkëshortes së tij shtatzënë, me të cilën jeton në një marrëdhënie familjare. Andaj gjykata ka vlerësuar se dënimi është i drejtë, dhe në harmoni me peshën e veprës penale, gjenden ekonomike dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit. Gjyqtari i vetëm gjykues, konsideron se me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Në fund, gjykata ka marrë parasysh edhe sanksionet tjera penale të përcaktuara me KPRK, mirëpo ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar, në mënyrë të plotë dhe të drejtë mund të arrihet qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi pagesën e taksës në emër të Programit për kompensimin e viktimave të krimit, është marrë në kuptim të nenit 36 par. 3 pika 3.1. të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimin për kërkesat pasurore juridike u mor në kuptim të nenit 457 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.84/23 të datës 29.02.2024

Gjyqtari
Refki Piraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.